



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2021:130564

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639810

C.nr.1753/21

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve H.Sh. nga fsh ..., Komuna e Shtimes dhe R.D. nga Shtimja, rr "...", nr....., të cilët me autorizim i përfaqëson av Kemajl Ademaj nga Ferizaj, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi L.M. nga Shtimja, në çështjen juridike, kompensim i shtesës në pagë sipas licencimit, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29 Prill 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësve H.Sh. dhe R.D., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, që paditësve H.Sh., për periudhën nga data 11.04.2014 deri më 17.04.2018 të i kompensohet diferenca në pagë në bazë të licencimit në vlerë prej 19% e pagës bazë dhe për periudhën nga data 18.04.2018 deri në pensionimin e tij më datë 24.02.2020 diferencën në pagë në vlerë prej 10% të pagës bazë. Po ashtu edhe kërkesë padia e paditësit R.D., për periudhën nga data 11.04.2014 deri më 17.04.2018, me të cilën ka kërkuar t'i kompensohet diferenca në pagë në bazë të licencimit në vlerë prej 27% e pagës bazë dhe për periudhën nga data 18.04.2018 deri në pensionimin e tij më datë 20.04.2020, diferencën në pagë në vlerë prej 10% të pagës bazë, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, **si e pa bazuar.**

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 23.06.2021, pranë kësaj gjykate, kanë parashtruar padinë, me të cilën kanë kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë,

ashtu që paditësve H.Sh., në emër të shtesës sipas kualifikimit për periudhën nga data 11.04.2014 deri më 17.04.2018, nuk ia ka paguar diferencën prej 19% të pagës bazë dhe as diferencën prej 10% për periudhën nga data 18.04.2018 e deri në pensionimin e tij më datë 24.02.2020. Po ashtu në padi ka theksuar se paditësit R.D. në emër të shtesës sipas kualifikimit për periudhën nga data 11.04.2014 deri më 17.04.2018 nuk ia ka paguar diferencën prej 27% të pagës bazë dhe as diferencën prej 10% për periudhën nga data 18.04.2018 e deri në pensionimin e tij më datë 20.04.2019. Shumat e kërkuara të paguhen me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës. Kërkesën e ka bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 11.04.2014 ku sipas nenit 7, ndër të tjera është përcaktuar se paditësit me licencim fitohet e drejta për punë , avancim karrierë dhe zhvillime profesionale dhe atë: Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë dhe mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% e pagës bazë. Po ashtu padinë dhe kërkesat e saj i ka bazuar edhe në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18.04.2017 sipas nenit 7, nga të cilat dispozita paditësit i takon kompensimi në pagë sipas kualifikimit në përqindje 10% e pagës bazë, ndërsa e paditura deri më tani nuk e ka kompensuar. Andaj ka kërkuar që padia dhe kërkesa e saj të aprovohen si të bazuara.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse sepse është e pabazuar. Në tej ka sqaruar se padia është bazuar në kontratën kolektive të datës 11.04.2014 kontratë kjo që dihet se ka vlefshmëri tri vjeçare që do të thotë se ka përfunduar të jetë në fuqi 11.04.2017 ndërsa padia është paraqitur në gjykatë më 23.06.2021 që i bie se kërkesa është parashkruar konform dispozitave të LMD-së. Po ashtu paditësit padinë e tyre e kanë bazuar edhe në kontratën kolektive të arsimit e nënshkruar më dt. 18.04.2017 e cila po ashtu nuk është më në fuqi. Për të gjitha këto arsye pala e paditur ka konsideruar se padia dhe kërkesëpadia nuk kanë bazë ligjore. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe kërkesat e parashkruara.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja

faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi dhe provat tjera rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pa themeltë.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399, par 1 dhe 2, të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Paragrafi 2 përcakton se kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 399, të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e pa themeltë pasi që pjesën e parë të kërkesës për kompensimin e shtesës për kompensim e ka arrirë afati i parashkrimit ndërsa pjesën e dytë të kërkesës për kompensim vërtetohet me prova se janë kompensuar.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, paditësi R.D. si mësimdhënës klasor në SHFMU “E.D.” në Shtime dhe paditësi H.Sh. si mësimdhënës, e që ky fakt gjen mbështetje në vendimet e pensionimit, listat e pagave të pranuar nga e paditura dhe diplomat e fakulteteve.

Gjykata vendosi që të refuzoj kërkesën e palës që në emër të diferencës sipas kualifikimit për periudhën nga data 11.04.2014 deri më 17.04.2018 nuk ia ka paguar diferencën prej 19% të pagës bazë, pasi gjykata morri për bazë kërkesën e palës së paditur përmes përgjigjes në padi, i cili ka kërkuar që padia të refuzohet pasi që ka theksuar se kërkesa është e parashkruar andaj edhe gjykata vendosi që kërkesën në fjalë ta refuzoj kjo ngase nga baza e padisë të cilën është thirrë paditësit shihet qartë se kërkesat për këtë periudhë i ka arrirë afati i parashkrimit. Kjo ngase kontrata kolektive e arsimit e datës 11.04.2014 në fuqi deri më 11.04.2017 paditësit ka paraqitur padinë më datë 23.06.2021, që i bie se paditësit kanë paraqitur padinë 4 (katër) vite e 2 (dy) muaj më vonë. Andaj, Gjykata vendosi që konform dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në bazë të nenit 353, në të cilin shprehimisht është paraparë : “Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të

shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”, ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve sa i përket diferenca në pagë në bazë të licencimit.

Gjykata sa i përket pjesës refuzuese lidhur me kompensimin e diferencës në pagë prej 10% për periudhën nga data 18.04.2018 e deri në pensionimin e tij më datë 24.02.2020 dhe për paditësin R.D. në emër të shtesës sipas kualifikimit diferencën prej 10% për periudhën nga data 18.04.2018 e deri në pensionimin e tij më datë 20.04.2019 sipas licencimit përkatësisht kualifikimit, kërkesat i refuzoi në tërësi për të dyja palët andaj edhe arsyetimin për to do ta jap së bashku ngase kërkesat janë të njëjta. Gjykata nga provat e prezantuara përkatësisht lista e pagës së pranuar për paditësin R.D. me numër të punësuarit EM0..., e datës 01.01.2019 dhe për paditësin H.Sh. me numër të punësuarit EM0.... lista e pagës e datës 01.02.2019, shihet qartë se paditësit kanë marrë shtesën sipas kualifikimit dhe atë R.D. për kualifikim ka marrë shumën prej 58.32 euro në muaj apo 10% e pagës bazë dhe paditësi H.Sh. ka marrë shumën prej 41.04 euro në muaj apo 10% e pagës bazë si kanë kërkuar në padi.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe të njëjtën e ka refuzuar sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e paraqitura ka vërtetuar faktin se kërkesat janë të parashkruara përkatësisht paditësit kanë realizuar kërkesat si në kërkesë padi.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera të palëve ndërgjyqës por ka gjetur se të njëjta janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar ku dhe i ka refuzuar kërkesë padinë përkatësisht kompensimin për periudhat e specifikuar në pikën II të dispozitivit.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452, par 1, të LPK-së dhe vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 399, të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**

C.nr.1753/21, me datë 29 Prill 2024

**Gjyqtari**

**Faton Ajvazi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.